
**AKTI I THEMELIMIT
DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ LEDI SMILE ” SHPK**



**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

“ LEDI SMILE ” SHPK

Sot , me date 13.10.2023, ne Tirane, Znj. Enkelejda Njazi Spahiu , e dtl 20.08.1976, lindur ne Poliçan, dhe banuese ne Tirane, shtetase shqiptare, madhore, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtese e leternjofimit me nr. Personal H65820180J e cila perfaqeson 100 % te kuotave te shoqerise duke vepruar ne cilesine e Ortakes Themeluese, vendosi te themeloje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar “ LEDI SMILE ” SHPK dhe vendosi te aprovoje kete Akt Themelimi dhe Statutin e Shoqerise sipas termave dhe kushteve te meposhtme:

TITULLI I

EMRI I SHOQERISE - REGJIMI JURIDIK - SELIA - KOHEZGJATJ

Neni 1

Emri i Shoqerise

1.1 Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, eshte krijuar Shoqeria “LEDI SMILE” SHPK, ne vijim referuar si “Shoqeria”.

1.2 Shoqeria ka logon dhe vulen e vet zyrtare.

1.3 Shoqeria ka adresen e e-mail klinikaledismile@gmail.com dhe Nr.Tel +355695122299

Neni 2

Regjimi Juridik i Shoqerise

2.1 “LEDI SMILE” SHPK, eshte nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

2.2 Aktiviteti i saj eshte i organizuar sipas dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe dispozitave ligjore ne fuqi mbi tregtine dhe legjislacionin civil ne Republiken e Shqiperise.

2.3 Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Shoqeria mund te ndryshoje regjimin e saj juridik, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe dispozitat e Statutit te saj.

2.4 Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.

NENI 3 Selia

3.1 Shoqeria ka seline e saj ne adresen: Njesia bashkiake nr.5, Rruga Irfan Tomini, Pallati ALFA Nr.16, Hyrja 4,kati 1, Ap nr.1.

3.2 Shoqeria mund te hape ose te mbylle dege, filiale dhe / ose zyra perfaqesimi brenda Shqiperise dhe / ose jashte vendit, ose te krijojte shoqeri te tjera me Partnere apo Aksionare pjesemarres.



Neni 4 Kohezgjatja

4.1 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqerise ne Regjistrin Tregtar. Ortaket e Shoqerise mund te vendosin te kufizojne kohezgjatjen e aktivitetit me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme.

TITULLI II

OBJEKTI

Neni 5 Objekti

Drejtim i klinikave dentare. Sherbime klinike stomatologjie.

TITULLI III

KAPITALI I SHOQERISE - TRANSFERIMI I KUOTAVE- ZMADHIMI I KAPITALIT

Neni 6 Kapitali i Shoqerise

6.1 Kapitali i shoqerise eshte ne vleren 100,000 Leke (njqind mije leke) i ndare ne 1 (nje) kuote.

Kapitali i shoqerise do te paguhet nga ortakja themeluese si vijon: Enkelejda Spahiu, nenshkruese e 1 (nje) kuote, e barabarte me 100 % te kapitalit te shoqerise, me nje vlere prej 100 Lek (njqind leke).

6.2 Pergjegjesia e Ortakeve ndaj paleve te treta per detyrimet e marra persiper nga shoqeria eshte e kufizuar sipas pjesemarrjes se ortakut/ortakeve ne kapitalin e shoqerise.

Neni 7 Transferimi i kuotave

7.1 Transferimi i kuotave te shoqerise ndaj paleve te treta i nenshtrohet se drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te cilet mund ta ushtrojne kete te drejte sipas kushteve te percaktuara ne nenin 7.2 deri ne nenin 7.6 me poshte.

7.2 Ne rast se nje ortak "Ofruesi" kerkon te shese dhe/ose te transferoje disa ose te gjitha kuotat e tij, ortaket e mbetur ("Ortaket e mbetur") do te kene te drejten e parablerjes ne lidhje me kuoten qe ofrohen per transferim ("Kuota e ofruar"), sipas kushteve te meposhtme:

(a) Ofruesi do tu dergoje fillimit ortakeve te mbetur nje njoftim me shkrim i cili percakton perqindjen e kuotes se ofruar , cmimin dhe kushtet e tjera te transferimit te cilat duhet te pershijne Identitetin e Bleresit ("OFERTA"), duke ftuar se pari Ortaket e mbetur te blejne aksionet e ofruara;



(b) Ortaket e mbetur do të kenë të drejtën të blejnë kuotat e ofruara përpjestimisht dhe sipas kushteve të ofertes, duke i dërguar një njoftim me shkrim ofruesit brenda një afati prej tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së njoftimit të Ofruesit.

7.3 Në rast se me shumë se një prej Ortakeve të mbetur dëshirojnë të blejnë kuotën e ofruar, secili prej këtyre ortakeve të mbetur do të ketë të drejtën të blejë kuotën e ofruar përpjestimisht sipas përqindjeve që zotërojnë në Shoqëri, duke i dërguar një njoftim me shkrim ofruesit brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditësh nga marrja e njoftimit sipas së cilit secili prej tyre dëshiron të blejë kuotën e ofruar.

7.4 Në rast se asnjë nga ortaket e mbetur nuk dëshiron të blejë kuotën e ofruar dhe/ose kanë refuzuar të blejnë kuotën e ofruar, sipas kushteve të përcaktuara këtu, brenda tridhjetë ditëve nga marrja e këtij njoftimi, Ofruesi do të ketë të drejtën të transferojë Kuotat e ofruara një pale të tretë me të njetin cmim që i është ofruar ortakeve të mbetur (sipas kushteve të ofertes fillestare). Nëse ky kusht nuk është përmbushur, Marrveshja për Shitjen e Kuotave me paletë të treta do të jetë e pavlefshme.

7.5 Në rast se ndonjë ose të gjithë ortaket e shoqërisë blen/blejnë kuotat e ofruara sipas kushteve të ofertes, siç përcaktohet me sipër, ky transferim do të kryhet sipas kushteve të ofertes.

7.6 Kushtet e parashikuara me sipër nuk do të zbatohen në rast transferimi të kuotave nga një ortak tek një shoqëri e cila ndodhet nën kontrollin e këtij ortaku ose në rast transferimi nga një ortak tek një pasardhës ose pasardhës i drejtpërdrejtë i tij ose tek bashkeshorti.

7.7 Dispozitat e nënve 7.1- 7.6, nuk do të zbatohen në rast transferimi të bërë në favor të ortakeve të tjera. Megjithatë, në këtë rast transferimi duhet të komunikohet fillimisht me shkrim ortakeve të tjera. Të gjitha njoftimet sipas këtij neni duhet të dërgohen edhe Shoqërisë.

Neni 8 Rritja e Kapitalit

8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të rrisë kapitalin e shoqërisë, në përputhje me kuorumin e përcaktuar në nenin 12 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti.

8.2 Në rast të një rritje të kapitalit, ortaket kanë të drejtë të nënshkruarimit të kuotave nëpërmjet kontributit në natyrë ose në të holla, në proporcion me përqindjen që zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.

8.3 Nëse ndonjë nga ortaket refuzojë të drejtën nënshkruarimit, kapitali mund të nënshkruhet nga ortaket e tjera. Në këtë rast, ortaket e tjera mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për nënshkrimin e kapitalit në proporcion me përqindjen që zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.

Neni 9 Zvogëlimi i Kapitalit

9.1 Asambleja e përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e shoqërisë, në përputhje me kuorumin e përcaktuar në nenin 12 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast, kapitali nuk mund të reduktohet nën vlerën minimale të përcaktuar me ligj.



9.2 Ortaket perballen me uljen e kapitalit te shoqerise ne proporcion me kuotat e zoteruara nga secili prej tyre ne kompani.

Neni 10

Certifikata e pjese marrjes

10.1 Secili nga ortaket gezon te drejten nje certifikate ne lidhje me perqindjen ne pjesen qe gezon ne kapitalin e shoqerise. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certifikate per kuotate mbajtura se bashku nga disa Ortake dhe shperndarja e certifikates per perfaqesuesit e perbashket e anetareve do te konsiderohet e dhene ne interes te te gjithë ortakeve, ne perputhje me dispozitat e ligjit.

TITULLI IV

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 11

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Vendimet e Shoqerise merren ne perputhje me ligjin per shoqerite tregtare.

Asambleja e Ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e ortakeve, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve si dhe përcaktimin e pages se administratorit
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga asambleja e ortakeve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 12

Administrimi



Administrator i shoqerise eshte z. Z. Daniel Lulzim Merdani , i dtl 11.12.1994, lindur ne Skrapar, dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal J41211040M.

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte riperteritje duke filluar nga data 13.10.2023 deri me 13.10.2028. Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakeve te shoqerise.

Neni 13 Kompetencat

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare.
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakeve te vetem për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakeve ne rastet kur :

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtezakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave te te gjitha niveleve, zyrave te tatim taksave, autoriteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti



i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Administratori lejohet të delegojë kompetencat tek nje person i trete nepermjet nje Prokure Noteriale, ne rastin kur ai e gjykon si te nevojshem per aktivitetin e Shoqerise dicka te tille.

Neni 14

Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakeve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer

detyrimet;
d) jep kredi.

TITULLI V VITI FINANCIAR, DIVIDENTI

Neni 15 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni16 Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.
Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 17 Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithvjeter dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve te shoqerise.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 18

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve të shoqerise.

TITULLI VI SHPERBERJA-NDARJA-BASHKIMI- LIKUIDIMI

Neni 19

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :
a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e tij;



- b) me vendim të ortakeve të shoqërisë;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- d) me vendim të gjykatës;
- e) kur shoqëria për dy vite rrjesht ka dale me humbje

Në këtë rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket e Shoqërisë.

Nëse Asambleja e Ortakeve nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 20

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakeve dhe administratorit.

Neni 21

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t’i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e

likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 22

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Neni 23

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të këtij shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 24

Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakeve të Shoqërisë, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.
3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e këtij të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasoje:
 - a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
 - b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
 - c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e tij nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

Neni 25

Shndërrimi



Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të tij në shoqëri aksionare
Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

TITULLI VII NDRYSHME

Neni 26 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këto statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptarë.
Për sa nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 27 Mosmarveshjet

Për mosmarveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nenshkruhet sot me datë 13.10.2023.

**ORTAKE E VETME E SHOQËRISE
" LEDI SMILE " SHPK
Znj. Enkelejda Spahiu**

